



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	<b>Drejtoria e Kadastrit</b>
Periudha raportuese	<b>Qershor 2019</b>
Drejtori:	Valbona Osmani-Mehmetaj

#### ***1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.***

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit **qershor 2019**, në **6** zyrat pritëse janë pranuar gjithsej **4,310** kërkesa, nga të cilat janë aprovuar **4,206** kërkesa, refuzuar **19** kërkesa dhe kanë mbetur në procedurë edhe **85** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes **2 sektorëve**: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

#### ***2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.***

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Kadastrit janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastralë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisve banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licensuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

#### ***3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.***

Në Drejtorinë e Kadastrit gjatë muajit **prill 2019**, përmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve, Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë, janë pranuar kërkesa të ndryshme, prej të cilave:

**Në Sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- **330** kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë aprovuar **287**, janë refuzuar **12** kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me **31** konkluzione, duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse;
- **6** kërkesa për historiate nga persona fizikë, institucione, prej të cilave janë aprovuar **6**;
- **213** shkresa, kërkesa nga institucione të ndryshme, prej të cilat janë aprovuar **162**, janë refuzuar **7** dhe në procedurë kanë mbetur **44**;
- **4** kërkesa për përmirësime, të cilat janë shqyrtuar dhe janë miratuar;
- **71** kërkesa për regjistrim të hipotekave dhe **51** kërkesa për çregjistrim hipoteke, ku janë aprovuar të gjithat;
- **172** përmirësime/ankesa/ plotësim lënde nga institucionet e ndryshme dhe janë aprovuar të gjitha.

**Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë: 848, nga të cilat 754 kërkesa janë aprovuar, 19 janë refuzuar dhe 75 kërkesa kanë ngelur në procedurë.**

**Në sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- **1948** kërkesa për certifikata të pronësisë dhe **1230** kërkesa për kopje të planit, ku gjithsej janë pranuar dhe realizuar **3178** kërkesa;
- **45** kërkesa për ndarje të parcelave dhe janë aprovuar të gjitha;
- **23** kërkesa për bashkim të parcelave dhe janë aprovuar të gjitha;
- **5** kërkesa për përcaktim të kufijve dhe janë aprovuar të gjitha;
- **11** kërkesa për rirregullim kufiri të parcelave dhe janë aprovuar të gjitha;
- **50** kërkesa për identifikimin e parcelave-njësive banesore, prej të cilave janë aprovuar **40** dhe **10** janë në procedurë;
- **68** kërkesa për dhënien e produkteve (koordinatave) dhe janë aprovuar të gjitha;
- **25** kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokave-parcelave dhe janë aprovuar të gjitha;
- **17** plotësime të lëndëve dhe janë aprovuar të gjitha;
- **3** kërkesë për regjistrim e objekteve dhe njësive banesore dhe janë aprovuar të gjitha;
- **37** kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet, si: Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Urbanizimit, Ministria e Planifikimit Hapësinor, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj, dhe janë aprovuar të gjitha.

**Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë: 3462, prej të cilave janë aprovuar 3452 dhe 10 kanë mbetur në procedurë.**

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se Drejtoria e kadastrit ka implementuar gati **90** për qind (%) të planit të saj, duke i aprovuar, refuzuar apo pezulluar kërkesat e palëve në procedurë sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

E arritur e Drejtorisë është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, ka arritur të nxjerrë vendime meritorë për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët /subjektet juridike.

**4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.***

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit,	Numri i kërkesave	Të aprovuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara
---	-------------------	--------------	--------------	--------------	-----------------------

Aktivitetet në implementim e sipër nga Sektori i kadastrit janë:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej **5** ditë pune, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Aktivitetet në implementim e sipër nga Sektori i gjeodezisë janë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njësive banesore;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

**4.1.1. STATISTIKAT-Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtorja juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.**

<b>qershor 2019</b>					
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i së drejtës për pronë të paluajtshme)	<b>330</b>	<b>287</b>	<b>12</b>	<b>31</b>	<b>13,386.00</b>
Kërkesa për historik zyrtar, fizik dhe juridik	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>90.00</b>
Kërkesa nga Institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	<b>213</b>	<b>162</b>	<b>7</b>	<b>44</b>	<b>103.00</b>
Përmirësime në RDPP	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>60.00</b>
Lirim të barrës tatimore	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>10.00</b>
Kërkesa të tjera: përmirësime, ankesa, plotësim lënde etj.	<b>172</b>	<b>172</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>83.00</b>
Kërkesat për regjistrim të hipotekës	<b>71</b>	<b>71</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>8,840.00</b>
Kërkesat për çregjistrim të hipotekës dhe ndryshime	<b>51</b>	<b>51</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>680.00</b>
Vendosje e barrës tatimore	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>00</b>
Certifikata të pronësisë dhe kopje të planit	<b>3178</b>	<b>3178</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>14,396.00</b>
Ndarjet – parcelim	<b>45</b>	<b>45</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>7,866.00</b>
Bashkimi i parcelave	<b>23</b>	<b>23</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,230.00</b>
Përcaktimi i kufijve të parcelave	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>140.00</b>
Rirregullimi i kufijve të parcelave	<b>11</b>	<b>11</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>290.00</b>
Identifikimi i parcelave dhe njësive banesore	<b>50</b>	<b>40</b>	<b>0</b>	<b>10</b>	<b>988.00</b>
Dhënia e produkteve - koordinatave	<b>68</b>	<b>68</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,671.00</b>
Ndërrimi i destinimit të tokës-parcelave	<b>25</b>	<b>25</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>57,387.00</b>
Plotësime të lëndëve	<b>17</b>	<b>17</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>90.00</b>
Regjistrim i objekteve dhe njësive banesore	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>6,920.00</b>
Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë (cert. dhe kopje te planit)	<b>37</b>	<b>37</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>164.00</b>
<b><u>Gjithsej</u></b>	<b><u>4,310</u></b>	<b><u>4,206</u></b>	<b><u>19</u></b>	<b><u>85</u></b>	<b><u>23,252.00</u></b>

#### 4.1.2 *Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese*

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të së drejtave pronësore në regjistrat kadastralë, përkundrazi kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

#### 4.1.3 *Takimet me palë*

- **Spektori i kadastrit** - gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë dy herë në javë (*të martave dhe të enjteve*) nga 2 orë në ditë, me dy zyrtarë ligjorë, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palës. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen me rreth **392** qytetarë.
- **Spektori i gjeodezisë** - ka takime të rregullta me palë dy herë në javë (*të mërkurave dhe të premteve*) nga 2 orë, ku gjatë muajit **qershor** ka pranuar **374** palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu, ka takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

#### 4. *Takimet me institucione të tjera*

- **Spektori i kadastrit** - takim me qytetarë për çështje të ndryshme kadastrale pronësore për të cilat kemi zgjidhje ligjore ose i kemi udhëzuar palët që t'u drejtohen institucioneve tjera në vend. Takim me Policinë e Kosovës, zyrtarë të Agjencisë Kadastrale të Kosovës etj, lidhur me lëndët në procedurë dhe çështje tjera.

#### 5.1.1 *Diskutime publike/takimet me qytetarë*

- Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur diskutime publike.

- 5. **Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare**- Spektori i kadastrit nuk ka pranuar asnjë kërkesë për dokumentacionin për dokumente zyrtare.

#### 6.1.1 *Lëndët e pranuarra, të kryera dhe në përfundim e sipër*

##### **Spektori i kadastrit:**

- Lëndë të pranuarra: **848**
- Lëndë të aprovuara: **754**
- Lëndë të refuzuara: **19**
- Lëndë në procedurë: **75**

##### **Spektori i gjeodezisë:**

- Lëndë të pranuarra: **3462**
- Lëndë të aprovuara: **3452**
- Lëndë të refuzuara: **0**
- Lëndë në procedurë: **10**

### *Takime të tjera*

- *Nuk kemi pasur takime të tjera.*

6. ***SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.***

#### **Spektori i kadastrit:**

- Sfidues është komunikimi me institucionet, mosdhënia e përgjigjeve në afate ligjore, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve;
- **19** kërkesa presin për verifikime në Arkiv Komunal dhe Ndërkomunal;
- **27** kërkesa presin për verifikime në Gjykatë;
- **3** kërkesa presin për verifikime në privatizim;
- **7** kërkesa presin për verifikime në NPB;
- **14** kërkesa presin për verifikime në KPA.

#### **Spektori i gjeodezisë:**

- Komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës është përmirësuar dukshëm sa i përket përgjigjeve të tyre në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me programin **Cadastral Map** dhe **SIKTK**, të cilat krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruktimit të disa zonave kadastrale nga **Agjencia Kadastral e Kosovës**.

7. ***REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.***

#### **Spektori i kadastrit:**

- Trajnime për punëtorë sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

#### **Spektori i gjeodezisë:**

- Trajnime për punëtorë

8. ***AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues***

#### **Spektori i kadastrit:**

- Lëndët në shpallje publike, në afat prej 5 ditë pune;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;

- Lëndët për verifikim në gjykata, NPB, AKP, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

### **Sektori i gjeodezisë:**

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisë banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

**9. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme**